



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROJEKT – REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMIN PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë:

-Duke vlerësuar qëllimin dhe misionin e punës së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për promovimin e një shoqërie me mundësi dhe shanse të barabarta, e duke luftuar çdo veprim apo mosveprim që sjell diskriminim;

- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion i pavarur, i cili ka për mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

- Duke mbështetur e nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, me shoqërinë civile, median dhe publikun;

Kuvendi i Shqipërisë, shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2018 dhe konstaton se:

-Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në mënyrë aktive për shqyrtimin e ankesave të adresuara drejtpërdrejtë institucionit, të referuara nga individët apo palët e interesuara, duke rritur numrin e rasteve të trajtuara, dhe duke zgjeruar tipologjinë e tyre.

-Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar një numër më të lartë ankesash krahasuar me vitin paraardhës. Çështjet e shqyrtuara me pretendim diskriminimin, në numër më të lartë i përkasin fushës së të mirave dhe shërbimeve dhe fushës së punësimit, sipas fushave të veprimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Në analizë të të dhënave të raportuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vihet re një numër më i lartë i ankesave drejtuar subjekteve publike, krahasuar me subjektet private me objekt “përshtatjen e arsyeshme të banesave sociale, institucioneve publike, apo përfitimin e shërbimeve publike”. Një vlerësim në rritje kanë regjistruar rastet e ankesave për shkak të gjinisë, ndërsa ankesat për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual dhe identitetit gjinor vijnë më të mbeten në numër të ulët.

-Hetimet administrative të nisura kryesisht nga Zyra e Komisionerit si instrument për identifikimin e rasteve të diskriminimit, janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2017.

-Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesave, konstatohet rritje e numrit të vendimeve të marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe shtimin e rasteve të konstatuara në cënim të parimeve të barazisë dhe që rezultojnë në diskriminim.

-Në analizë të numrit të rasteve të raportuara, numri i vendimeve të marra me konstatim mosdiskriminimi është më i lartë në raport me vendimet me konstatim diskriminimi. Vendimet e marra me “Konstatim diskriminimi” për shkak të racës dhe aftësisë së kufizuar mbeten në numër të ulët.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë rekomandime për projekt ligje dhe akte nënligjore, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me kuadrin ligjor në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. KMD në ushtrim të funksioneve ligjore, ka dhënë rekomandime për çështje të veçanta drejtuar disa institucioneve shtetërore.

-Ka një rritje të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në gjykata, për sa i përket vendimeve gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por edhe rritjen e numrit të vendimeve gjyqësore, për pranimin e padive duke konstatuar diskriminim dhe dhënien e dëmshpërblimit.

-Me ndryshimet e strukturës dhe organikës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të miratuara nga Kuvendi gjatë vitit 2018, u bë e mundur rritja e kapaciteteve administrative të institucionit, me një shtesë prej 11 punonjësish, si dhe u mundësua prezenca e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me 3 zyrat rajonale përkatësisht në qytetet, Korçë, Shkodër dhe Fier.

-Më datë 29 tetor 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka organizuar Konferencën e tretë Rajonale të Institucioneve të Barazisë, me temë “Pavarësia e Institucioneve të Barazisë”, ku morrën pjesë organet e barazisë së Evropës Juglindore, duke rritur rolin dhe vizibilitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nivel rajonal.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka patur një rol më proaktiv në media, me qëllim informimin e opinionit publik me veprimtarinë e institucionit, duke rritur numrin e pronocimeve publike të Komisionerit në median vizive, të shkruar, si dhe të pasqyruara edhe në faqen zyrtare të institucionit në rrjetin social. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kushtuar vëmendje të veçantë promovimit të praktikave të mira institucionale në televizione kombëtare.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit të opinionit publik, me qëllim informimin mbi njohjen e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rolin e Komisionerit, përmes zhvillimit dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e ndërgjegjësuere në disa qytete të vendit, duke përfshirë disa target grupe si: punonjësit e sektorit të arsimit, të bashkive, që mbulojnë shërbimet sociale, mbrojtjen e vajzave dhe grave nga dhuna, me bazë gjinore, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit e zyrave rajonale të punës, përfaqësues të ojf-ve.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qënë pjesë e një sërë aktiviteteve institucionale me qëllim forcimin e bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat vendase dhe të huaja që punojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është angazhuar në hartimin e raporteve, raportimeve në kuadrin e e organizmave ndërkombëtarë dhe rajonale, si dhe në procesin e integritetit evropian.

- Kuvendi i Shqipërisë, kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2019, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht dhe në këto drejtime:

- Të rrisë rolin monitorues të institucionit në drejtim të zbatimit dhe respektimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, duke pasqyruar gjetjet e monitorimit në raporte të veçanta.
- Të forcojë rolin proaktiv të institucionit, të garantojë se çdo ankesë drejtuar institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të trajtohet në kohë dhe me efektivitet, duke mundësuar zbatimin efektiv të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Të rrisë iniciativat hetimore ex officio në rastin e shkeljes së të drejtave të njeriut mbi baza diskriminimi, duke fuqizuar monitorimin dhe duke rritur kapacitetet e stafit të tij për identifikimin e çështjeve ex officio.
- Të garantojë pjesëmarrje aktive dhe fuqizimin institucional nëpërmjet rritjes së numrit të rasteve/ çështjeve gjyqësore, duke pasqyruar domosdoshmërinë institucionale dhe zgjerimin e grupeve përfituese, në përmbushje të qëllimit dhe objektit të ligjit.
- Të identifikojë dhe të propozojë ndryshime dhe përmirësime ligjore të kuadrit rregullator në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, që rrjedhin prej punës kërkimore dhe analizave të thelluara dhe krahasimore të çështjeve të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të forcohet roli i institucionit në rajonet ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka zyrat rajonale, për të zgjeruar aktivitetet gjithëpërfshirëse ndërgjegjësuese dhe informuese, jo vetëm në zonat urbane, por edhe në ato rurale, me qëllim promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim;
- Të rrisë numrin e rekomandimeve drejtuar institucioneve publike dhe sektorit privat në drejtim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të fuqizojë bashkëpunimin me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore, në shkëmbimin e raporteve tematike, në identifikimin e çështjeve përfaqësuese dhe në advokimin për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me shanse të barabarta.
- Të realizojë monitorimin e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në fushën e punësimit, arsimit dhe të mirave dhe shërbimeve, dhe të paraqesë një raport të veçantë në komisionin për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, mbi rezultatet e monitorimit të aksesueshmërisë.

- Të paraqesë një raport të veçantë në lidhje me diskriminimin e fëmijëve për komisionin për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.
- Të bashkëpunojë me median si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin në media dhe si partner në rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Miratuar në datën _____.____.2019